

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut dhe mos u përçani" (Ali-Imran 103)

# BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder  
 Vitit I i botimit, Shkurt 2008 Nr 10. Çmimi 20 lekë.  
 www.gazetabesimtari.com; e-mail: info@gazetabesimtari.com  
 Kryeredaktor Selim Gokaj



## PERFAQESUES TE SHTETIT SHQIPTAR APO MERCENARE TE POLITIKAVE ANTIISLAME DHE ANTISHQIPTARE

Ambasadori i Shqipërisë në SHBA, Aleksandër Sallabanda, në një prononcim të tij të kohëve të fundit, u bë pjesë e shumë politikanëve shqiptarë të cilët e kanë bërë mode që të etiketojnë fenë islame si fatkeqësi e shqiptarve dhe e vetë Shqipërisë. E vërteta është se feja islame u bë pjesë e mburojes së identitetit të shqiptarëve, kur ata po konvertoheshin nga fqinjët e tyre sllavo-ortodoksë duke u damkosur me një kryq ortodoks në ballë. Ardhja e fesë islame në Shqipëri i ndihmoi shqiptarët që të distancoheshin nga rreziku i fqinjëve ortodoksë, duke bërë që të dëbohen këta asimilues të rrezikshëm. Duke piketuar

rritjen e kretibilitetin e vet dhe të atyre që janë prapavijë e tij, ambasadori Sallabanda tashmë ka vendosur që t, i fetarizojë figurat tona kombëtare. Kësaj rralle ai ka vendosur që ta fillojë me Skenderbeun duke i dhënë atij "medaljen e heroit të krishtërimit". E vërteta është se Skenderbeu ka qënë i perkëdheluri i Papës dhe sulmues i katoliçizmit në Ballkan, akte që janë paraqitur në thujse 50 botime. Por, rilindasit tanë, që janë pjesë e artë e historisë shqiptare, të cilët, me pozicionin që i dhanë në letërsinë dhe publicistikën e tyre, duke i shtuar edhe politikën, ku u pozicionuan, ata e konturuan figurën e Skenderbeun, duke i dhënë atij një pamje legjendare dhe duke e ngritur Skenderbeun në piadestalin e heroit kombëtar. Ishin vite, kur për shqiptarët kishte rendësi jetike nacionalizmi dhe jo petku fetar në dhënien e vlerave të figurave të rendësisë së vaçantë për atë. Duket që rilindasit e kishin kuptuar se vetëm karakteri kombëtar dhe nacionalist mund të ishin promotorët të lëvizjes së shqiptarve për pavarësi. Të mos harrojmë ambasadori Sallabanda se shqiptarët i përkasin tri feve dhe rilindasit nuk e merrnin përsipër rrisun që një fe të ishte pararojë e luftës për pavarësi në Shqipëri. Një Skenderbe, që lufton për katoliçizim do të ishte kataklizëm për piadestalin ku atë e kanë ngritur rilindasit shqiptarë.

Në qoftë se ne e pranojmë Skenderbeun si figurë fetare dhe në shërbim të Papës, atëherë ne do ta pyesim ambasadorin Sallabanda se kush do të



përfaqësonte shumicën muslimane që ishte përcaktuese për të sjellë ditën e Pavarësisë. Dhe i kujtojmë këtij ambasadori që është pozicionuar larg interesave kombëtare, se ata që luftuan në një linjë me Papatin, kanë pasë emblema të krishtera dhe flamuj kryqtarësh. Një Skenderbe, që kishte bashkuar të gjithë princat shqiptarë që të mbronte trojet shqiptare, ishte për papatin një armë pa kosto me të cilin mund të bëhej një aleancë për interesat e Papatit. Ambasadori Sallabanda bën një faj të pafalshëm duke i dhënë Skenderbeut kartën e një mercenari, i cili paska qënë Princ i Krishtërimit dhe se paska luftuar për Krishtërimit duke bërë sektare figurën e tij, të cilën shqiptarët e njohin si hero kombëtar. Faji i rendë i këtij ambasadori e redukton Skenderbeun në një kryqtar dhe e gjithë lufta e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Skenderbeut, merr pamjen dhe misionin e një kryqzate të cilën historigrafia shqiptare kurrë nuk e ka konstatuar. Po të jemi në një linjë me ambasadorin tone në SHBA, atëherë ne do të

ishim për rrafshimin e vlerave kombëtare dhe egzaltimin e vlera fetare deri në absurditet. Nuk dime nëse e di ambasadori Sallabanda se ai po bëhet pjesë e ideologjisë serbe që përdor fenë për të portretizuar shqiptarët të cilët për serbet janë turq muslimanë. Muslimanët shqiptarë nuk mund ta pranojnë Skenderbeun si një princ që ka luftuar në emër të krishtërimit turq muslimanë, sepse, po të arsyetojmë në këtë, linjë ai paska luftuar fenë e tyre duke i dhënë kësaj figure historike një pamje sektare, sipas së cilës ai i takon vetëm pakicës së shqiptarve. Kurse muslimanëve u takon të kenë për hero të tyre, Sulltan Mehmetin, që luftoi për të mbrojtur fenë e tyre. Interesant është se Sallabanda lakon figurën e Nënë Terezës e cila po bëhet normë për referime, aktivitete politike e fetare duke harruar këta mercenarë, me prapavijë të dyshimtë, se ajo zonjë i ishte përkushtuar religjonit të saj duke u bërë murgeshë. Përpjekjet për t, i dhënë ngjyrë kombëtare janë një vetdemaskim për ata që po çirren se zonja punoi për Shqipërinë. Ajo ishte një misionare e krishterë që investoi për të rritur vlerat e fesë së saj nga edhe i mori vlerësimet duke u lumturuar dhe duke u shenjturuar. Prandaj, i duhet dhënë kësaj zonje atë që i takon. Dhe ajo që i takon është se ajo është thjesht një misionare bamirëse e krishterë. dhe shumë larg një figureje kombëtare.

Ambasadori Sallabanda duhet të mos harrojë se përfaqëson shtetin shqiptar që ka një popullsi me shumicë muslimane e cila është themeli mbi të cilën janë arritur vlerat e shqiptarve. Ambasadori Sallabanda nuk përfaqëson një fime private që mendon se do të shpërblehet për tezat e zeza që ai hedh në media kundër muslimanëve. Duke iu kundërvënë realitetit historik të shqiptarve, ai tashmë ka veshur petkun e një mercenari të cilit ministria e jashtme shqiptare e ka obligim "T'ia ulë rrogën"

Doan Dani  
 Student në Itali

**MENDIME PËR BASHKË-  
 EKZISTENCËN NDËRFETARE NË  
 REALITETIN SHQIPTAR** Fq 2

**FYTYRA E RREZIKSHME E  
 MAKS VELOS NE EKRANIN E  
 TV KLANIT** Fq 3

**FAKTORI NDERKOMBETAR  
 NE KOSOVE PO ZBATON  
 SKENARIN E BOSNJES** Fq 4

**EVROPA PARA SFIDËS MUSLIMANE** Fq 5

**DUAJA E SULLTAN  
 MURATIT PER KOSOVEN** Fq 6

**DRITA HYJNORE I DHUROI  
 SYLEJMAN TURKUT  
 BESIMIN ISLAM** Fq 7



# Mendime për bashkëekzistencën ndërfetare në realitetin shqiptar



Bashkëegzistenca dhe bashkëjetesa në mes religjoneve fetare ka qenë dhe do të jetë kusht i rendësishëm dhe i vetëm që religjonet fetare të jetojnë në paqë dhe miqësi dhe flaka e luftës në mest ë religjoneve fetare të mbesë vetëm në arkivat historike. E vërteta është se mendimtarë, nga religjonet kryesore fetare, janë bazuar në librat e shpallura nga Zoti për të ndërtuar traktate dhe për të dhënë mendime dhe zgjidhje që bashkëegzistenca dhe bashkëjetesa fetare të jetë pjesë me rendësi e jetës shoqërore. Në rrallë, përsa i përket rendësisë së trajtimit të kësaj teme, janë prononcimet e klerikëve të religjoneve fetare të cilët janë thelluar edhe më tepër në trajtimin e kësaj teme, kuptohet sipas interesave të tyre, sipas religjonit të cilit ata i përkasin, duke shtuar këtu edhe klerikë që kanë një prapavijë diversioniste të cilët nuk dihet se "Në çfarë furre e marrin bukën" Eshhtë e vërtetë se mungesa e kësaj bashkëegzistence fetare është pasuar me lumenj gjaku, haraç të cilin e kanë paguar besimtarët e mashtruar, frymë e injektuar nga qarqe radikale dhe ekstremiste fetare- politke. Shqipëria, me tre fetë e saj monoteiste, ka qenë me fat që nuk ka njohur dhe nuk ka provuar përplasje religjonesh dhe rrjellimish nuk ka pare as pasojat rrënuese të këtyre përplasjeve. Ka shumë mundësi që shqiptarët, që praktikojnë këta tri fe, janë tolerantë dhe janë të shpëtuar nga ekstremet e rrezikshme, të cilat lehtësisht marrin misionë shkatërrimtare që gjithmonë kanë pasë një prapavijë dhe diversion nga qëndra të rrezikshme ndërkombëtare që planifikojnë përplasje fetare për t, i hedhur nesër në terren. Por, është fak që edhe në Shqipëri provokimet, me pasoja, nuk kanë munguar të cilat janë njohur në Shkodër, që kanë degjeneruar deri në përplasje të gjakosura në mes të muslimanëve dhe të katolikëve, fakt që e pohon edhe kleriku Lazer Shantoja e cila është e cituar në veprat e tij. Megjithëse krishterët dhe muslimanët, siç pohon kleriku Gjergj Fishta, i

kanë kishat dhe xhamitë e ndame, mehallë e katunde të ndame, shëgerta në dugajë të njeni tjetrit nuk kanë, ata mundën të jetojnë të qetë dhe në miqësi me njëri tjetrin duke i zvogluar në një minimum të pranueshëm këto përplasje. Bashkëegzistenca në mes të religjoneve nuk ka aq shumë bazë fetare, sesa bazë qytetare, sepse vertet besimet fetare një zoti i luten, por mënyra e lutjes dhe parimet e rendësishme mbi të cilat funksionon lutja ndaj zotit janë të ndara. Nuk duhet të spekullojmë me thënien e Profetit Muhamedit a. s. që na kujton se i bardhidhe i ziu, arabi dhe jo arabi nuk kanë epërsi mbi njëri tjetrin, sepse këtu nuk bëhet fjalë për bashkëegzistencë fetare, por për unitet mrenda umetit muslimane. Kuptohet që hedhja në media e shtrembërimeve të tilla është antiislame dhe e rrezikshme, sepse mund të fshehë edhe qëllime diversioni kundër muslimanëve. Bashkëegzistenca fetare, që të jetë reale dhe e pranueshme, ajo duhet të ketë gjithmone dy partnerë që të jenë të dy të interesuar që kjo bashkëegzistencë të funksionojë realisht dhe jo për vitrinë Muslimanët, historikisht, janë treguar tolerantë model, kujtojmë mbrojtjen që ata u dhanë të krishterëve në Kuds, në kohën e kalifëve muslimanë që po marshonin fitimtarë për të përhapë mesazhin islam, tolerancë që nuk u pa tek kryqëzatat e krishtera që pushtuan Kuds duke dhënë pamje gjaku që historia deri tashti nuk i ka pare. Aq më keq që deri nga Papatit nuk është kërkuar falje ndaj muslimanëve dhe flitet se papa i ri i ka marrënë mbrojtje kryqzatat. Ndigjojmë se bashkëegzistenca fetare, sidomos në Shkodër, është forcuar edhe nga lidhjet martesore ne mes qytetarve me besim të kundërt. Fetarisht një muslimani i lejohet që të realizojë një lidhje martesore me një grua të një feje tjetër në raste të veçanta, por jo të kthehet në norme për tëforcuar bashkëegzistencën fetare, aq më tepër që një vajze muslimane nuk i lejohet, për asnjë arsye, që të martohet me një jomusliman. Ne do të citojmë

Kryetarin e Bashkësisë Islame të Bosnjes, të nderuarin Mustafa çeriç i cili, haptas deklaroi se nuk i rekomandon martesat e përziera, sepse ata kanë probleme, duke i shtuar këtij pohimi një hytbe brilante që ish myftiu, Haxhi Bashkim Bajraktari, mbajti në xhaminë Ebu Beker për pasojat që mund të kenë për muslimanët martesat e përziera. Pohimet e këtyre zotërive janë të pranueshme, sepse ne njohim shumë raste, kur femijët janë të ndarë në dy drejtime; njeri në kishë e tjetri në xhami, duke arritur edhe të ndërrojnë emrat e tyre në tentativa për të gjetur identitetin e vet, sikurse ka pasë raste të veçanta, ku familja e përzier fetare ka gjetur lumturinë

Por, duhen gjetur argumente që të pranosh një bashkëegzistencë reale, sidomos në Shkodër. . Nuk mund të jetë bindës argumenti se kur muslimanët faleshin në xhami, dyqanet ua ruanin të krishterët, në një kohë që qytetarët as që mendonin të merrnin mall në një dyqan pa njeri, sepse e quanin këtë veprim një gjynah që zoti e ndëshkon. Sidomos me origjinën e feve duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe mos të spekullojmë në emer të një tolerance që faktikisht duhet të egzistojë Feja islame është sot e vetmja fe burimore, sepse fetë e tjera monoteste kanë devijuar dhe janë përpunuar duke qenë larg asaj që është shpallur nga zoti. , sepse duke arsyetuar ndryshe, ne lëvizim nga pozicioni jonë islam. Nuk mund të jenë fe burimore ato fe që i bëjnë partner dhe fëmijë zotit.

. Nuk mund të pranojmë që të na thuhet për të vertetë pohimi se Jezusi u jepte sihariq ndërtuesve të paqes sepse kështu krijohet një hendek me muslimanët, që nuk qenkan paqësorë kurse të krishterët qenkan paqësorë dhe ndërtojnë hapësira paqeje. , në një kohë që, në emër të paqes. , qyteteve dhe shteteve muslimane po u del tymi në maje. A ka fe ibrahimite në Shqipëri dhe a është baza ibrahimite tregues për bashkëegzistencë fetare në Shqipëri? Përgjigjen e jep Sureja (Al Imram67) që thotë se Ibrahimit nuk ka qenë as jahudi, . as i krishterë, por ishte larg besimeve të kota, ishte musliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve


Kur ne flasim për martesat e përziera, nuk duhet t, i idealizojmë, sepse do të ishte një thirrje për martesat e përziera në të gjitha hapësirat shqiptare, duke u përgaditur që nesër Allahu të na ndëshkojë si u ndëshkuan muslimanët në Bosnje ku, në katër martesat, një ishte e përzier me fetë ndryshme.

Ne shkodalet muslimanë e duam shumë bashkëjetesën fetare, por nuk pranojmë që, për hir të kësaj bashkëegzistence, të pranojmë kthimin xhamiave në kisha, as të na vënë shenjtorë katolikë në hyrje të qytetit dhe të vendosen kryqe në hapësira publike, aq më tepër të na japin karta identiteti me shenjtorë të krishtera me kryq në dorë. Muslimanët dhe të krishterët do të jetojnë në një bashkëegzistencë fetare, kur t, u tregohet vendi provokatorëve dhe atyre që i sheqerosin mardhënjet muslimane krishtere për intesa personale, ose më keq shkruajë ose flasin me porosi, që nesër të shpërblehen.

Mendojmë dhe besojmë se në Shkodër do të jetojnë në paqë muslimanët dhe të krishterët pa ndihmën e tellallëve që nuk dihet në emër të kujt flasin.

Haxhi Vehbi Dani  
Shkodër me 24 janar 2008





# FYTYRA E RREZIKSHME E MAKS VELOS NE EKSTRANIN E TV KLANIT

Në emisionin Opinion, që drejtohet nga gazetari Blendi Fevziu, i cili shikohet përmes ekranit të televizionit Klan, teleshikuesit shikuan në ekran ish- të persekutuarin, Maks Velo, një figurë e njohur mediatike i cili, kur tregon për vuajtjet në burgun komunist, nuk harron të vjell vrer dhe të persekutojë bashkëatdhetarët e tij shqiptarë që i përkasin fesë islame. Menduam se kësaj rralle, Maks me mjekër, që aq shumë i ngjante Marksit, nuk do ta shfrytëzonte ekranin e Klanit për të bërë rolin e prokurorit duke ngritur akuza të rënda dhe të rrezikshme për bashkombasit e tyre muslimanë (gjithmonë në se Maks Velo është shqiptar). Pasi akuzoi me të drejtë sistemin komunist, si një dukuri e rrezikshme shoqërore e cila rrënoi Shqipërinë dhe burgosi dhe azgjësoi mijra qytetarë të pafajshëm, i persekutuar, Maks Velo, na shokoi me mendimet dhe vlerësimet e tij për shumicën e popullsisë shqiptare që i përket besimit musliman. Për këtë të persekutuar, që është i gatshëm të persekutojë shumicën e muslimanëve shqiptarë, , periudha me e zezë e historisë së popullit tone është ajo e Perëndorisë Osmane, kur shqiptarët iu bashkangjitën fesë islame. Për Velon, ky veprim ishte një tradhëti ndaj fesë së të parve që e bëri pjesa më emadhe e popullsisë duke u kujtuar shqiptarëve se serbet, grekët dhe popuj të tjerë nuk e bënë këtë tradhëti. Maks Velo di vetëm të sulmojë, por nuk pranon të arsyetojë përse shqiptarët iu drejtuan fesë islame të cilët tek kjo

fe gjetën armën që u mungonte për të përballuar asimilimin ortodoks të sllavëve që kishin vërshuar rrezikshëm në Ballkan, aq më tepër që feja islame i përshtatej më mire karakterit krenar dhe të forte të shqiptarit. Ishte pikërisht feja e re e cila i bëri shqiptarët të jenë më të vendosur për të mbrojtur kufijtë nga ushtritë e rrezikshme sllave, kur kemi parasysh se për fenë islme dashuria për atdhe buron nga Imani(feja)Ruajtja e fesë së tyre nga grekët, serbët, bullgarët e popuj të tjerë nuk tregojnë ata ishin më trima e më të forte se shqiptarët, por se Perendoria Osmane nuk përdori dhunë ndaj popujve me fe të kundër, sepse turqit, si muslimanë që ishin, zbatuan devizën e islamit se në fe nuk ka dhunë, Për ilustrim kujtojmë se vetëm 5% e popujve në Perëndorinë Osmane u konvertuan në fenë islame, Falë tolerances, me të cilën me të drejtë krenohet historia e Perëndorisë Osmane. , I verbuar nga alergjia dhe urrejtja për 500 vitet, kur shqiptarët faktikisht bashkëjetuan me turqit, Maks Velo arrin të shfaqojë diktaturën duke deklaruar se fajin për vitet e burgut komunist i kishin 500 vitet e sundimit turk duke na detyruar të mendojmë se ku janë ato fije që nuk po i hiqen nga zverku këtij antimuslimani të cilit Islami i është bërë si fantazma që e ndjek pas edhe në gjumë Na habit dhe na shqetëson fakti se çfarë figurash të rrezikshme mund të prodhojë urrejtja kundër muslimanëve në hapësirën njerëzore. I kujtojmë Maksit, që i ngjason

Marksit, se edhe ato njolla që nuk u konvertuan nuk tregojnë se ishin më shqiptarë se ato që u konvertuan. Por, ishte politika administrative e Perëndorisë që la zona të lira dhe vetadministrative si :Mirdita, Himara, Suli dhe hapësira të tjera shqiptare. Është kjo figurë intelektuale e dyshimtë që sulmoi Kosovën dhe kosovarët duke qenë i gatshëm të votojë kundër një referendumi që mund të bashkonte Kosovën me Shqipërinë, duke arsyetuar se kosovarët janë injorantë e na sjell telashe dhe se është më mire t, i zgjidhin punët e tyre ata vetë Vetë një serb mund të jetë në një linjë mendimi me këtë Velon që shkumëzonte në emision më shumë kundër muslimanëve se kundër diktaturës që e vuri pas hekurave.

Të vjen keq, por njerëz të tillë e kanë pasë hak persekutimin, sepse vetëm pas hekurave ato bëhen të parrezikshëm Të lire ato pa tjetër krijojnë urrejtje dhe përçarje në mes të shqiptarëve ku fitues janë vetëm forcat antishqiptare ku, me dashje apo pa dashje, militon edhe i ashtuquajtur i intelektual, Maks Velo, i cili, me ato qo thotë publikisht në media, po bën konturet e një shoqërie shqiptare ku urrejtja fetare mund të bëhet leva e Arkimit për shkatërrimin e saj.

*Selim Gokaj  
Shkodër me 20 janar 2008*

## A DO T'I FALIN KOSOVARET ATO QE U PERDHUNUAN GRATE DHE VAJZAT E TYRE

Luftërat gjithmonë kanë qenë përplasje të ashpra ,të cilat kanë lënë pas shkatërrime dhe viktime të cilave nuk u dihet saktë numuri . Vrasjet janë bërë gjithmonë duke përdorë një slogon justifikues se luftë bëhej dhe hakmarrja kërkon gjak .Por, luftërat kanë edhe një kapitull që lakohet rrallë, por që nga shkalla e krimin thujse ajo rënditet gjithmonë e para. . Janë përdhunimet e grave dhe vajzave ata që e rrisin gjithmonë shkallën e krimin dhe të turpit të një lufte, sidomos kur përdhunimet bëhen një gjë e zakonshme për një ushtri , kur inkrimini i saj nuk njihet kufij. Janë pikërisht përgjnimet e grave dhe vajzave ato që lënë pasojë që nuk shuhen kurrë nga jeta dhe kujtesa e të përdhunuarave dhe të atyre që, së bashku me ata, i kanë përjetuar këto akte që janë tipar për kriminelë me fytyrë njeriu. E verteta është se ushtri dhe popuj të vaçantë janë shquar për përdhunime duke ia rritur kështu kurbën krimin deri në infinit.

Duke vëshruar dosjet e histories, njeriu ka mundësi të bëjë konturet e një tabele ku përdhunuesit konkurojnë me njëri tjetrin dhe me një angazhim minimal mund të vëmë re se kjo është një patologji e popujve sllavë të cilët, për hir të së vërtetës, e meritojnë medaljen e turpit për përdhunimet që ato kanë bërë në zjarrin e luftërave ,sikur të mos u mjaftonin varret dhe krimet që ushtritë e tyre linin pas ngado që ata shkonin. Në Bosnje ushtria serbe dhe formacionet e tyre paramilitare bënë përdhunime ndaj grave dhe vajzave muslimane boshnjake që u pane vetëm gjatë

luftës së dytë botërore, kur trupat e ushtrisë së kuqe përdhunuan mbi 2 milion gra dhe vajza polake dhe gjermane ,akte që filluan me përdhunimin e 100000 grave e vajzave gjermane ditën e pare të hyrjes së trupave sovjetike në Berlin si ushtri fituese .Dhe mos të harrojmë se ato trupa ushtarake kishin në udhëheqje komisarët politikë të partisë që ka mundësi të ishin edhe ata pjesë e këtij përdhunimi

.Lufta shfarosëse që repartet ushtarake serbe dhe vetë serbët e Kosovës bënë në spastimin e frikshëm etnik të vitit 1999, ishte kopje e asaj që vëllezërit e tyre sllavë paten bërë para tyre. Nuk mjaftuan vrasjet, rrëmbimet dhe masakrat ndaj popullsisë së pambrojtur kosovare, por ato i dhanë krimeve të tyre dimensione që historia rrallë here mund t,i shohë dhe t,i dokumentojë duke i bërë kështu përdhunimet e vajzave dhe grave kosovare pjesë të rëndësishme të strategjisë së tyre , për të goditur dhe traumatizuar deri në pakufi moralin e familjeve kosovare . Flitet për 3000 raste përdhunimesh të dokumentuara që u bënë në podrumet e Universitetit të Prishtinës , për përdhunime që u bënë nëpër fusha e male ,nëpër shtëpia dhe në hapësira të tjera ku lëvizte dhe gjendej popullsia e pambrojtur e Kosovës. U bënë përdhunime në sytë e vëllezerve, në sytë e baballarve dhe fëmijve . U bënë përdhunime në sy të nënave, ku nuk munguan edhe përdhunimet në grupe. Është formuar një shoqatë për rehabilitimin e këtyre fatkeqeve pa harruar se janë ndoshta më shumë në

numur ato, që nga turpi dhe pasojat që mund të kenë pas, nuk deklarojnë atë që provuan mbi trupin e tyre . Disa nga të përdhunuarat treguan haptas tmerrin që provuan me qëllim që ato, të cilët do të vijnë pas, të kenë kujdes që mos ta pësojnë nga egërsirat serbe që mbeten gjithmonë egërsira .Pavarësia e Kosovës tashmë duket se është çështje ditësh ,sepse faktori ndërkombëtar po e nxit politikën kosovare që ta deklarojë Pavarësisë duke u bërë thirrje serbve të Kosovës që të kthehen e të bashkëjetojnë në një Kosovë të Pavarur.

Po a do të kthehen në Kosovë edhe serbët e Kosovës që u bënë pjesë e përdhunimit të grave dhe vajzave kosovare?

A do t. falin kosovarët këta përdhunues të neveritshëm dhe shokët e tyre në Serbi në këmbim të një Kosovë të Pavarur? Vështirë të ndodhë një amnisti për përdhunuesit, sepse përdhunimet që u bënë ndaj grave dhe vajzave në Kosovë i kalojnë përmasat e një krimi lufte, për shkak se morali i përdhunuar nuk njihet as rehabilitin as shërim. Falje për përdhunuesit nuk ka, as nuk duhet të këtë .Për ata ka vetëm denim . Dhe denimin më maksimal duhet ta japë ligji, i cili duket se në Kosovë tashmë është i vonuar.

*Selim Gokaj  
Shkodër, me23janar 2008*

# FAKTORI NDERKOMBETAR NE KOSOVE PO ZBATON SKENARIN E BOSNJES



Shpallja e Pavarësisë së Kosovës duket se tashmë do të jetë një çështje e cila, pasi është lakuar në mes serbëve dhe kosovarëve, është lakuar në mendimet pro të Perëndimit dhe jo të Rusisë, do të njohë zgjidhjen e saj që ka të planifikuar, prej atyre që e nxisin dhe e mbështesin edhe pjesën më të rrezikshme të saj, e cila ka të bëjë me atë që do të ndodhë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Për Rusinë dhe Putinin e saj, janë 200 pika në planet që do ta pësojnë nga akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sepse edhe ata do të hidhen në sulm për një pavarësi që mendojnë se u takon si kosovarëve. Por, kur e vë re me kujdes njeriu se si faktori ndërkombëtar po e nxit politikën kosovare që të shpallë pavarësinë dhe nga ana tjetër e garanton se edhe do ta njohë këtë pavarësi, mendja na shkon me shpejtësi tek skenari që faktori ndërkombëtar zbatoi ndaj Bosnjes në vitin 1992. Ishin pikërisht ato, që quhen bashkësa ndërkombëtare që e nxiti Bosnjën të shpallte pavarësinë dhe për ta çuar deri në fund skenarin e saj, bëri edhe aktin e rrezikshëm të njohjes së pavarësisë së Bosnjes, veprime që u pasuan me një luftë, ku gjaku i njerëzve të pafajshëm ishte më i lexuari i atyre ditëve të pëgjakshme. Nuk dihet në se do të funksionojë me të njëjtat parametra, si në Bosnje, skenari që faktori ndërkombëtar ka përgaditur për Kosovën. Por, është mire që të mos gobjomë në parashikime dhe ta trajtojmë faktorin ndërkombëtar rregullator për probleme që lidhen me fatin e popujve të vegjel si populli i Kosovës, në një kohë që ngjarjet po rrukullsen me shpejtësi dhe ditët që do të vijnë pas nuk dihet se ke do të ngrohim më shumë, serbët apo kosovarët. Që kur faktori ndërkombëtar pranoi që serbët të instaloheshin të plotfuqishëm në veri të Kosovës, nuk ishte e vështirë që të

parshikohej se pas këtij instalimi serb ishte miratimi i bashkësisë ndërkombëtare për të lënë të gatshme një hapësirë ku një shkrepse e vogël do ta bënte flakën e madhe Flitet për angazhim forcash në veri të Kosovës dhe për gatishmëri për të përballuar incidentet pas shpalljes së Pavarësisë, në një kohë që serbët lihen të lire të votojnë si pjesë e Serbisë mbrenda territorit të Kosovës Mendojmë se në veri të Kosovës do të fillojë përplasja që pastaj mund të marrë trajtën e një veprimi zingjir i cili nuk do të ketë përmasat e Bosnjes, por të përbashkët me Bosnjën do të ketë viktimat e pafajshme. Mos po flitet për kufij të rinj në Ballkan dhe rikompozim etnik në hapësirën e Ballkanit? Koha nuk është shumë e gjatë, kur ne do ta shohim diçidurën e rrezikshme që ka hartuar faktori ndërkombëtar në Ballkan e cila, si gjithmonë do të jetë kundër interesave të shqiptarëve. Nuk mund të jenë shpëtimtarë ata që u zvogluan hapësirat shqiptarëve për të zgjeruar hapësirat për serbët, grekët, maqedonasit, sepse ishte faktori ndërkombëtar ai që planifikoi dhe zbatoi një Shqipëri Londineze, duke lënë jashtë kufijve të saj mijra kilometra dhe miliona shqiptarë. A do të jemi ne dëshmitarët e çuarjes në vend të kësaj padrejtësi shekullore nga politika evropjane? Vështirë se do të jenë të fituar shqiptarët në Kosove dhe në hapësira të tjera, ku ata jetojnë, nga mbështetja që po jep bashkësia ndërkombëtare për të shpallur Pavarësinë e Kosovës, një bashkësi që nuk po bashkohet për të formuar një bllok në mbështetje të Kosovës. Por një gjë dihet me siguri të padiskutueshme. Kosova është e përgaditur të jetojë e lire dhe e pavarur, pavarësisht kostos që do të ketë liria dhe Pavarësia e Kosovës.

**Veshguesi.**

## BANKA KOMBETARE GREKE RRACIZEM NDAJ MUSLIMANEVE

Ramazan Buku është inspektor prej 12 vitesh në Bashkinë e Tiranës në drejtorinë e tatim taksave dhe tarifave vendore. Si çdo person i lire, që kërkon të përfitojë një kredi, ai i është drejtuar një muaj më parë Bankes Kombëtare Greke në Tiranë. Deri këtu gjithshka ka shkuar mire për Ramazanin. Por, në momentin, kur ai ka dorëzuar një kërkesë për kredi në këtë bankë, kjo kërkesë nuk i është pranuar, por ka pasë edhe shumë arsye absurde sipas tij. Ai është shtangur nga arsyetimi i sekretares dhe më pas i bordit drejtues i bankës. Sipas tij, arsyetimi se nuk është kredituar ka qenë, se ai është i përkatësisë muslimane. Sipas Ramazanit, rasti i tij nuk është i vetëm, pasi ka edhe 37 persona të tjerë me emra muslimanësh që u është mohuar drejta e kreditimit. Ai akuzon Bankën Tregtare Greke për rracizëm ndaj përkatësisë muslimane, duke krijuar një pëçarje në rrallët e popullit shqiptar. Buku ka marrë një kredi në një bankë tjetër dhe e ka shlyer mrenda rregullave të kreditimit të vendosura nga banka. Kredia që ai kërkon të marrë nga banka greke është vetëm 2 milion lekë të vjetra. Por, pas ofendimit që i ka bërë bordi i kësaj banke, Ramazani nuk ka ndërmend të kthehet më aty. Gazeta "Sot" ka kontaktuar me zyrën e informacionit pranë Bankës Greke, lidhur me akuzën e ngritur nga qytetari Ramazan Buku, por akoma nuk ka marrë përgjigje nga banka. Unë kam kërkuar një kredi në Bankën Kombëtare Greke përpara një muaji. Kam marrë një vendim që jam punonjës i drejtorisë së taksave dhe më pas kam shkuar për të plotësuar një formular në këtë bankë mrenda të gjitha rregullave. Prita një javë që të më kthenin përgjigje, por që në fillim më thane se do të ndeshem me disa vështirësi. Sekretarja më tha se këtu ka disa probleme, sepse këtu vazhdon të jetë ndjenja e rracizmit. Këtë gjë ajo ma tha në kofidencë. Por, unë në fillim nuk e besova dhe vendosa t, i shkoi kredisë deri në fund. Pasi më kërkoi numurin e telefonit, banka nuk më ktheu përgjigjedhe më vonë unë shkova dhe i kërkova arsyen përse nuk është dhënë kredia, sepse unë jam një person që i plotësoj të gjitha kushtet e kredisë. Por, duket se diçka tjetër fshihej pas kësaj heshteje. Kjo duket ishte të qenurit musliman nga ana ime. Ramazani vazhdoi të flasë duke theksuar se do të marrë kredi në një bankë tjetër. Kjo që po bën banka greke është një rracizëm i vërtetë tha Ramazani. Unë nuk jam shumë i shqetësuar se nuk ma dhanë mua kredinë, por kredinë ia kanë mohuar ia edhe 37 personave të tjerë. Unë jam krenar që jam musliman, siç janë krenarë ata që janë ortodoksë e përfundoi fjalën e tij Ramazan Buku. (Nga arkivi i mediave të Shkruara)

## SINAGOGA HEBREJE AFER MESXHIDUL AKSASE AGRESIVITET DHE RREZIK

Sekretari i përgjithshëm i Konferencës Islamike, Ekmeludin Ihsanoglu, tërheq vërejtjen dhe shpreh rrezikun që shfaqet nga masat e marra nga grupet ekstremiste çifute për të ndërtuar një sinagogë hebreje afër xhamisë Al Aksa, sepse ndërtimi i kësaj sinagoge është paraparë në token e Mesxhidul Aksasë. Këtë hap, Enmeludin Ihsanoglu, e konsideron të rrezikshëm dhe armiqësor nga ana e Izraelit, për arsye se direkt është duke prekur vendet e shenjta islamedhe njëkohësisht ndjenjat e muslimanëve në të gjithë botën, duke ngjallë kështu nervozizëm dhe armiqësi të madhe.

Ai apelon deri te Kombet e Bashkuara që të kenë përgjegjësi dhe të ushtrojnë presion mbi Izraelin që të tërhiqet nga ky hap i ndërmarrë dhe të respektojë ligjet ndërkombëtare të cilat nuk lejojnë që okupatorët të ndryshojnë objektet dhe vendet fetare ose historike.

(Nga arkivi i mediave të Shkruara)



# Evropa para sfidës muslimane

Nexhat Ibrahimi



Religjionet, ideologjitë, kulturat e qytetërimet që përfaqësojnë dhe propagandojnë konceptin e jetës së izoluar, të veçuar në bashkësi të caktuara, pa integritet e bashkëpunime, janë të gabuara dhe historikisht të gjykuara për dështim.

Evropa deri në vitet e 60-ta të shekullit XX posedonte 'njëfarë' multikulturalizmi, por i përcjellur me njëfarë racizmi moralo-kulturor, sepse mendohej se evropianët posedojnë një epërsi politike, kulturore e shkencore, madje të lindur, trashëgimi kjo judeo-kristiane dhe greko-romake. Mirëpo, ky multikulturalizëm manifestohej brenda vetvetes, mes "vlerave" protestante, katolike, liberale dhe socialiste evropiane. Por, me fillimin e depërtimit dhe migrimit të muslimanëve nga Afrika veriore, nga Turqia por edhe nga Ballkani (shqiptarët dhe boshnjakët), vlerat e vjetra tradicionale, respektivisht multikulturalizmi tradicional, filloi të zbehet e të pëlças para rrethanave të reja. Kësaj klime të izolimit, të ndjenjës së epërsisë, i ndihmoi edhe "konvertimi" i shtresës së njerezëve të edukuar në mjediset fetare dhe tradicionale evropiane në majtistë radikalë. Kjo shtresë që më herët e konsideronte veten antikolonialiste dhe antiraciste, kampion të multikulturalizmit, u bë mbrojtës i të a.q. vlerave iluministe kundrejt ortodoksisë muslimane në migrim e sipër në Evropën Perëndimore. Shtresa e tillë sa frikësohej nga kthimi i sërishëm i religjionit në Evropë dhe rrezikimi i vlerave laiciste-shekullariste, për më tepër frikësohej nga depërtimi i religjionit islam. Kjo kthesë në Evropë e sidomos në Holandë, bëri që multikulturalizmi evropian, i mbështetur në shtyllat tradicionale, krahas shtyllave të pranishme, të fitonte edhe një shtyllë të re, atë islame. Për më tepër që shoqëria perëndimore, por as vetë muslimanët nuk dinin se si do të duhej të dukej kjo shtylla e re, islame-muslimane, në mjedis të ri dhe konstelacion të ri ideshë dhe veprimesh.

Mirëpo, me lëvizjet më të reja në botë, me konfliktet e fundit në botë, formimi i kësaj shtylle të re tashmë ka dështuar edhe në rrafshin ideor edhe në rrafshin praktik. Dialogu ndërmjet shumicës që dëshiron të imponojë rregulla të

lojës si të vetmet të drejta (globalizmi) dhe pakicës në rolin inferior dhe përbuzës, parapakisht është e gjykuar të dështojë. Pakica, natyrisht do të izolohet dhe krijojë mekanizma të mbrojtës, sepse, dëshiroam ne apo jo, ata janë pjesë e Evropës dhe nuk kanë ndërmend të heqin dorë nga vlerat e tyre religjioze dhe kulturore-historike, me të cilat krenohen dhe për të cilat janë në gjendje të luftojnë.

Mbi evropianët është që qëndrimin e tyre përjashtues, bindjen e tyre të gjoja një qytetërimi superior dhe shikimin e tyre nga lartsia ta shndërrojnë në qëndrim partneriteti, mirëkuptimi dhe kooperimi; me fjalë të tjera, evropiani duhet të mësojë të jetojë me muslimanin dhe të respektojë vlerat fundamentale të tij pikërisht sikurse kërkon t'i respektohet e kaluara e tij dhe e drejta në të ardhmen.

Në këtë aspekt, edhe muslimanët mund të ndihmojnë, duke dhënë kontributin e tyre në përshtatjen rrethanave të reja. Edhe ata duhet të respektojnë realitetin e ri, të krahasojnë me vlerat e fqinjve. Për këtë kanë bazë fetare si në Kur'an ashtu edhe në Hadith.

Deri sa Evropa nuk i pranon fëmijët muslimanë të lindur në Evropë si fëmijë të saj, edhe pse me vlera religjioze e kulturore tjetërfare, dhe deri sa fëmijët muslimanë nuk posedojnë ndonjë ndjenjë dhe nevojë për vendlindjen e babajve të tyre, këta fëmijë e gjejnë derën e hapur në vlerat fetare islame, por me një dozë skeptike ndaj evropianit dhe vlerave të tyre. Islami për ta bëhet shtëpi, bëhet vendlindje, bëhet mekanizëm mbrojtës përballë skillave dhe haribdeve të kohës, bëhet rruga e vetme për perspektivën e tyre individuale dhe kolektive, politike, kulturore dhe religjioze.

Qëndrimi i evropianëve, i ligjeve të tyre gjoja liberale, kurse në praktikë, në të shumten e rasteve dogmatike-raciste, do të ndikojë në rrjedhat e ardhshme evropiane. Nëse Evropa zgjedh këtë të fundit, dhunën dhe eksplotimin, përjashtimin e të tjerëve dhe superioritetin mbi të tjerët, nëse Evropa zgjedh mbrojtjen e vlerave iluministe, shekullariste në mënyrë dogmatike dhe të dhunës, pa dyshim se evropianët do ta dënojnë veten me pasojat të paparashikueshme.

Evropa duhet të matë çdo fjalë dhe veprim të vetin, kur janë në pyetje muslimanët. Veprimi i një individi, apo grupimi politik musliman nuk duhet të bëhet shkak për fushatë të vrazhdë kundër muslimanëve. Jemi dëshmitarë se veprimet e nxituara ishin dhe janë kundërproduktive. Rasti i ofendimit të muslimanëve nëpër Evropë (Hondandë, Francë etj.) është treguesi më i mirë.

Nacionalizmi dhe fanatizmi i dikurshëm evropian është zëvendësuar me nacionalizmin dhe fanatizmin iluminist. Kur kësaj i shtohet edhe "racizmi kulturor" se vetëm "kultura evropiane" është e mirë, çështja evoluon në shumë pikëpyetje. Harrohet se "kultura" më e mirë nuk matet me vlera territoriale dhe racore, por me vlera ideshë dhe vlerash praktike fetare, morale dhe kulturore.

Evropa do të gabojë edhe më shumë dhe me pasojat edhe më të rënda, nëse gjatë shekullit XXI e thellon hendekun me muslimanët në Evropë. Stili bushist, sarkozist, putinist i integritit të muslimanëve në shoqëritë jomuslimane i ngjan stilit integruës millosheçevian të muslimanëve shqiptar, apo boshnjak, apo të ngjashëm nëpër botë.

Prandaj, Perëndimi, si shumicë, duhet të ofrojë një bashkëpunim konstruktiv e të sinqertë, kurse muslimanët, si pakicë, duhet të pranojnë ofertën për bashkëjetesë dhe mirëkuptim, njohje të ndërsjellë, apo së paku muslimanët duhet të tolerojnë mendimet dhe vlerat e ndryshme.

Vetëm me njohje dhe mirëkuptim të ndërsjellë mund të jetojmë në paqe dhe lumturi pa marrë parasysh faktorin gjeografik, religjioz, kulturor e qytetëruës. Muslimanët tash 15 shekuj kanë pranuar në parim trashëgiminë judeo-kristiane, në radhë janë judeo-kristianët ta pranojnë Islamin, Muhammedin a.s. dhe Kur'anin e shenjtë.

## Na ndihmo o i madhi zot

*Ti o Zot çdo gje krijove  
Për të mirën e njerëzisë.  
Tok e qiell si shtroje e mloje  
Me gjithshka i ke paisë.*

*Mos mirënjohëse tregohet bota  
Veçanarisht qenia njerëzore.  
N, vend t, gjelbrimit prodhon bomba  
Sikur vehten t, mos ta donte.*

*Edhe fëmijve të parritur  
Egërsinë ua kultivojmë.  
N, vend t, kukllave syndritura  
Me pushkë e thika i furnizojmë.*

*Xhamia ne na këshillon  
Me Kur'an e me Hadithe..  
Humanizmin t, kultivojmë  
Në mes fëmijve dhe të rinjve.*

*Na ndihno ,o i madhi Zot  
Na largo nga antinjerëzorja.  
Nga të këqiat që kemi sot  
Janë të gjitha me pasoja.*

*Në xhami forcojmë vllazërinë.  
Me Kur'anin vlerësojmë shkencën.  
Pranë me t, mirën jo dëshprimi  
Vetëm kështu vlerësojmë jetën.*

**Vehbi Hoti Shkodër me 16.1.2008**

## DUAJA E SULLTAN MURATIT PER KOSOVEN



Për nder të natës së madhe të Kadrit, natën e 27 të muajit të shenjtë të Ramazanit të vitit 2007, në xhaminë e Emin Pashës në Prizren, u organizua një program madhështor i cili filloi që nga ora 24 te natës dhe zgjati gjer në ora 5 të mëngjesit. E tërë hapësira e brendshme e xhamisë dhe sipërfaqja e jashtme e oborrit ishte përplot me qindra burra e gra, shumica e të cilëve ishin të rinj e të rejat. Ishte me të vërtet një natë impulsive dhe e paharrueshme për qytetin e lashtë të Prizrenit, djep i kulturës dhe civilizimit islam në Kosovë. I tërë ky program ishte organizuar në nderim të natës së 27 të muajit madhnueshem të Ramazanit, natë në të cilin ka zbritur Kur'ani Famëlartë, natë e cila është me e vlefshme se 1000 muaj tjerë apo 83 vjet. Programi i natës filloi me faljen e 2 reqateve namaz të natës të cilin e udhëhoqi imami i xhamisë së Emin Pashës ,Hafiz Daud Lezi. Namazi i natës që disa vjet me radhë është bërë tradicional në Prizren dhe falet në 10 netët e fundit të Ramazanit. Namazi i natës karakterizohet me faljen e dy nga dy e reqateve të namazit i cili dallon prej namazeve tjerë, me ç'rast në kijam këndohen sure më të gjata të Kur'anit Famëlartë si dhe qëndrimi në ruku dhe sexhde është më i gjatë se prej namazeve të zakonshme ditore, javore, mujore apo vjetore. Pas kësaj imami i xhamisë, Hafiz Daud Lezi mbajti një ligjëratë të shkurtër rreth rëndësisë së natës së madhe të Kadrit, i cili përveç tjerash tha se në këtë natë në tërë rruzullin e kësaj bote me qindra, mijëra dhe miliona njerëz anembanë globit e festojne këtë natë të mrekullueshme me namaz nate, ligjërata, këndim të Kur'anit, ilahi, kaside, dua dhe lutjet të cilët në këtë natë të veçantë janë të pranueshme tek Allahu i Madhëruar ,inshallah. Më tutje vazhdoi programi me faljen edhe te dy reqateve namaz nate të cilin i udhëhoqi Hafiz Hysamedin Çesko, më tej programi vazhdoi me këndimin e ilahive dhe salavateve nga muezini ,Fetah Aqifi, Bashkim Çabrat, Fadil Shala e mysafirë tjerë prezent. Më tej vazhdoi me këndimin e ashereve nga Kur'ani Famëlartë, vazhdoi me ligjërata edhe nga Idriz Bilibani, ilahi, dua dhe lutje për nder të kësaj nate të veçantë të lejletul Kadrit. Programi i natës vazhdoi gjer në ora 3.30 me lutjen e përbashkët nga imami i xhamisë ,Hafiz Daud Lezi për pranimin e agjërimin, ibadetin, shëndetin, begatisë si dhe pavarësisë së Kosovës nga Allahu i Madhëruar , me ç'rast, pas përfundimit të këtij programi, për të gjithë të pranishmit u përgatit syfyri i përbashkët. Është karakteristike se iftaret e përbashkëta e tani edhe syfyre të përbashkëta, i ka të veçantë qyteti i Prizrenit ,i cili çmohet me traditë dhe përvojë shumëvjeçare, për të cilin vetëm një natë më parë në iftarin e

përbashkët

moren pjese rreth 600 vetë, ku ishin pjesemarres shumë mysafir nga anembanë Kosovës, te cilet na shtrënguan duart dhe na falënderuan për mikpritje madhështore dhe se vetëm qyteti i Prizrenit mund të organizojë këto aktivitete fetare në mënyrë më të mirë, sepse posedon kulturë, traditë të lashtë të qytetërimit dhe civilizimit islam, për të cilin ne të tjerët, vetëm mund të ëndërrojmë. Me të vërtet kam shëtitur shumë qytete si: Sarajevën, Jeni Pazarin, Shkodrën, Shkupin, Stambollin, por netët e Ramazanit si në Prizren nuk ka mundesi t,i shikosh. Dikush do të më akuzojë se jam tepër lokalist, por nuk është fjala per lokalizem për qytetin tim të Prizrenit, por realiteti është i tillë .Falë këshillit të xhamisë dhe grupit entuziast të palodhshëm në krye me Salajdin Dorambari e Fatih Kroqi, Ismajlhaki Kazazi, Edis Vata, Agron Rekathati, Erhan Mujollari, Mexhit Ibrahim, Muhamer Shiliku, Xhevdet Kabashi, Tyran Xhejlani, Mergim Berisha dhe donatorëve te tjerë të xhamisë si dhe sponsorëve Benaf dhe Abi u shtrua një syfyri i përbashkët me specialitete tipike të Prizrenit si: topliat të cilit enkas në mënyrë të posaçshme në Prizren përgatiten, djathë Sharri, ullinj, hurma, ëmbëlsira, lëngje dhe ajran.

Programi përfundoi me faljen e përbashkët të namazit të sabahut me shpresë dhe dëshirë që Allahu i madhëruar të ketë pranuar këtë program të mrekullueshëm të përgatitur për natën e Lejletul Kadrit si dhe agjërimin dhe ibadetin e kryer gjatë muajit të Ramazanit.

Edhe unë si pjesëmarrës i kësaj nate të mrekullueshme ,bëra dua, lutje për të gjithë shokët dhe vëllezërit tonë si në Kosovë, nënë Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë, Turqi si dhe në të gjitha trojet islame anembanë botës me dëshirë dhe lutje që Allahu t'ju përforcojë besimin, t'ju shtojë dijen, t'i begatoje me pasuri, t'i stolise me gjithë të mirat e kësaj dynjaje, paralelisht duke kontribuar dhe qëndruar krenar dhe stoik në përkatësin e tyre fetare islame.

Do të përfundoj këtë përshkrim të kësaj nate të mrekullueshme dhe të paharrueshme të natës së madhe të Kadrit, me lutjen të cilën e ka bërë Sulltan Murati, një natë para betejës së Kosovës në vitin 1389, të cilin shpresoj dhe besoj që Allahu i madhëruar me të vërtet ia ka pranuar:” Ja Allah! Të lutem që në këtë fushë të bukur të Kosovës, të bij shehid(dëshmor) në fushëmejdani, që Islami të ngadhënjë dhe nuri(drita) e tij të mos fiket gjer në ditën e Kijametit në këtë fushë të bukur të Kosovës”.

Faik Miftari

## I VOBECT ASHT SYNI QE KURR S'QAN

*I vobekt asht syni që kurr s, qan  
Zemra që s,friksohet ka shok belanë.  
Nefsi që s,ngopet vehtes i hap varr  
Duaja që s,pranohet asht shok me zjarr  
Kur me lutje e vepër Allahut i rrijmë pranë  
Atëherë shejtani gjen belanë.  
Nga halli e zori kërcen përpjetë  
Se rob ai s,do të kurrë jetë.  
Njerëzit që për Zotin duan të punojnë  
Aty don shejtani të penetrojë.  
Jep e merr ai, kurr s,pushon  
Hyrje e çarje ai shumë kërkon.  
Besimtarit s,i ndahet dit as nat  
Që atij t,i prij në fesat.  
Se me te ka qefin e lezetin  
Me çdo mënyrë t,i mohojë xhenetin.  
Me muslimanin e dobët lehtë e ka  
Atë e mposht, lolo e ka ba.  
Në mes të fëmijës dhe pasurisë  
Shejtami mbjell farën e xhelozisë  
Me intriga besimtarit i sillet  
Kur ta dobësojë ,si ujku t,i sulet.  
Prandaj kërkohet dhe gjithmonë duhet  
Që besimtari gjithmonë të ruhet.  
Vetëm nga Allahu asht mbrojtja e tij  
Vetëm kujdesi i tij na jep siguri.  
Që rruga për fitore mire t, shtrohet  
Me fjalë e vepër Allahu të kujtohet.*

Burhan Fili  
Miçigan shtator 2007

## CIA DHE MOSADI LICENCA PER TE VRARE

Dhjetra agjentë të shërbimeve amerikane dhe izrailite janë të shpërndarë në të gjithë botën , në vendet ku mbizotëron kriza. Për vite me rrallë, pasi është praktikuar spiunazhi elektronik dhe ai radiomarrës, shërbimet sekrete në mbarë botën i janë rikthyer spiunazhit të qenieve njerëzore. Kjo është parulla që nxerr CIA me qendrën e saj në Langely. Aty është drejtor Porter Grosi cili ka urdhëruar dhjetra oficerë policie dhe burokratë të punojnë nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 5 pasdreke. Ai i urdhëroi të braktisin tavolinat e punës dhe të përgaditen të udhëtojnë në pikat më të nxehtatë botës,

Mosadi është shërbimi sekret izrailit që është ndër më të famshmet në botë. Terroristët në mbarë botën janë paralajmëruar, që nga Hamasi deri tek Al-Kaeda. Celulat e Mosadit kanë leje për të eliminuar armiq të më të rrezikshëm të shtetit hebrej.Për të dytën here, që kur është caktuar për të drejtuar shërbimin sekret të Mosadit ,Meir Daga .i ka lejuar axhensisë për të vepruar edhe në vendet e tjera. Në vitin 2003, Meir Dagan organizoi shërbimimin sekret të Mosadit duke ndjekur dy drejtime kryesore. Njëri ishte drejtimi operativ dhe tjetri ai administrative.

Para se të vihej ne krye te drejtimit të Mosad ,Dagan ishte veteran i inteligjencës, ndërsa tashti është komandant i njisive speciale Neviot e njohur me inicialin T. Drejtimi i dytë i është caktuar Zotni H. me cilësinë e shefit të stafit. Është caktuar që këto dy drejtime të Mosadit do t,i alternojnë rolet ne çdo 2 vjet e gjysmë .Gazeta italiane , Panorama, shkruan se Dagan ka bërë marrëveshje me Sharonin për të realizuar spiunazhin me qeniet njerëzore. Operacioni i shtatorit të vitit 2004 në Damask ,ku u vra udhëheqësi Hamasit, ka qenë një mësim që ka treguar se celulat e Hamasit kanë lejen për të eliminuar armiq të më të rrezikshëm të shteti hebrej.

(Nga arkivi i mediave te Shkruara)



# Drita Hyjnore i dhuroi Sylejman Turkut besimin Islam



Sylejman Turku: 1803-1928

Ngjarja që do të tregoj më poshtë nuk është as trillim, as krijimtari prej shkrimtari, as dëshirë, as ëndërr, por një ngjarje e vërtetë që ndodhi në fillimin e vitit 1818:

Ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç kur doli nga shtëpia e tij, nga Karma e Mirditës. Quhej Lekë Bici. Rrugës shoqërohej nga vëllai i madh i tij. Ai do të vendosej në fshatin Rragam të Shkodrës, në familjen e kumbarës së tij të quejtur Murat Osmani, gjyshi i Isen Osmanit. Këtu Leka do të vihej në shërbim të familjes së kumbarës, i cili do ta shpërblente me një sasi paresh që do ta shikonte të arsyeshme. Lekë Bici nuk e mendonte kurrë se largimi nga shtëpia do t'i ndryshonte gjithë jeten e tij.

Në familjen e Murat Osmanit, Lekë Bici nis një jetë të re. Gjëja e parë që i la mbresa në shpirtin e tij, ishte mënyra se si myslimanët lidheshin me Zotin e tyre. Ndryshonte në themel nga ritet e besimit katolik në kishë. Siç i tregonin të rinjtë myslimanë, çdo besimtar komunikonte me Zotin e tij pesë herë në ditë. Ata faleshin edhe në shtëpi, edhe në xhami. Myslimanët para se të faleshin, pastronin trupin, merrnin abdes, pastaj duke u drejtuar nga Qajba kryenin faljen sipas rregullave islame. Leka nuk e kuptonte pse myslimanët binin me fytyrë në tokë, ose siç i thonin ata, me krye në sezhdë duke iu lutur Allahut të tyre për jeten e përtejme, për jeten qiellore.

Lekë Bici në kontakt me të rinjtë e familjes dhe të fshatit Rragam fillon ta pëlqejë besimin islam. Ai nis të shkojë në xhami çdo ditë të premte dhe gradualisht fillon të mësojë mënyren e faljes. Ai, sa hynte në xhami ndiente në shpirt një respekt disi të veçantë. Ai mbushej me një ndjesi që i dukej se vinte nga qielli. Ndihej i lumtur në shpirt se diçka po kryente në rrugën e vërtetë, në rrugën e Zotit. Fillon të mësojë sure nga Kur'ani dhe lutje islame, rregullat e faljes.....

Ishte natë Bajrami kur Lekë Bici ndihej shumë i sëmurë. Kishte temperaturë. Me gjithë kujdesin e madh të familjes së kumbarës, duke i shërbyer për t'ia ulur temperaturën, ai gjatë gjithë natës edhe në mëngjesin e ditës së parë të Bajramit gjendet nën ndikimin e një temperature të lartë. Ai dëshironte me gjithë shpirt që të shkonte për të falur Bajramin, por gjendja e tij e rëndë nuk e la të shkonte në xhami.

Në kohën që myslimanët po falnin Bajramin, do të ndodhte mrekullia me Lekë Bicin. Do të ndodhte ajo mrekulli që do t'i ndryshonte gjithë jeten e tij. Në një gjendje të një temperature të lartë, në një kllapi mes jetës dhe vdekjes, i paraqitet si një vegim, as ëndërr, as zgjuar, as gjallë, as vdekur, silueta e hoxhës i veshur krejtësisht me troba të verdha prej floriri, dhe me një mjekër të gjatë e të bardhë. Hoxha hyri në dhomë dhe u nis drejtë tij tek krevati. Ai ngjasonte në fytyrë me hoxhen e Rragamit. Afrohet ngadalë, ulet praën tij dhe i vë gishtin tregues në

mes të ballit duke e thirrë tre herë me emrin: "Sylejman! Sylejman! Sylejman!" në intervale kohore të njejta. Në këtë moment ai del nga kllapia e temperaturës së lartë dhe habitet kur vëren se nuk ka asnjë farë temperature, pra ndihet krejtësisht i shëruar. Çohet shpejtë nga krevati dhe shkon në kuzhinë, i thotë zonjës së shtëpisë, që po piqte petullat e Bajramit, t'i jepte disa petulla për ta qerasë hoxhen. E zonja e shtëpisë bashkë me Leken kërkojnë hoxhen nëpër shtëpi për ta qerasë por nuk e gjejnë.

Lekë Bici mendon me vete: "Tri herë më thirri hoxha me emrin "Sylejman!" dhe mbasi tri thirrjeve në personin tim kishte ndodhur mrekullia, isha i shëruar krejtësisht!"

Mbasi kryhet falja e Bajramit, hoxha bashkë me njerejëzit e shtëpisë së Murat Osmanit shkon për të uruar Bajramin në familje. Leka bashkë me zonjen e shtëpisë e pyesin hoxhen se nga kishte humbur kur e kërkuan për ta qerasë Ai u tha se nuk kishte qenë në shtëpi në atë kohë por në xhami. Pastaj ai i pyeti se si qëndronte puna. Leka i tregoi hoxhës se si i qe paraqitur si në ëndërr kur ai ishte me temperaturë ta lartë. Hoxha e kuptoi se Lekës i qe paraqitur një nga ëngjëjt e mëdhenjë të Zotit, ndaj dhe ishte një shenjë i mirë për te.

Nga ky moment Lekë Bici vendosi të bëhej mysliman dhe si emër pranoi emrin Sylejman që ëngjëlli ia kishte përsëritur tre herë. Leka i kërkoj hoxhës që ai t'i tregonte kushtin që e lejonte të kthehej mysliman. Hoxha i tha se shtylla e parë e besimit islam ishte dëshmia. I ndihmuar nga hoxha, Leka bëri dëshminë: "Dëshmoj se së ka tjetër Zot veç Allahut dhe Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij!" Lekë Bici i vetëquejtur Sylejman Turku(Karma), ra shehadet dhe pranoi Islamit si fe. Nga kjo ditë ai quhet Sylejman Turku.

Një vit, nga dita e largimit nga Karma, shkon vëllai i tij në Rragam për ta marrë, por Sylejman Turku nuk pranon të kthehet më në Karmë, pasi ishte konvertuar vullnetarisht në mysliman. Me këtë rast krijohet konflikt mes këtij dhe vëllait që kishte shkuar për ta marrë. Gjithashtu vëllai i tij hyn në konflikt edhe me familjen e Murat Osmanit, e cila, sipas tij, e kishte prerë në besë që e kishte detyruar Leken të konvertohej në mysliman. Por Leka i thotë se familja e Murat Osmanit nuk kishte asnjë faj, pasi ishte zgjedhja e tij për t'u kthyer në fenë islame, në fenë e vërtetë. Në fund vëllai i thotë Lekës se ku do t'i linte prindërit, kush do t'i mbante babë e nënë të moshuar!? Sylejman Turku i thotë të vëllait se prindërit do t'i mbante ai gjithë jeten, me kusht që të konvertohen në myslimanë dhe të shkojnë me te. Në të kundërtën t'i mbante ai me vëllezërit e tjerë pasi të gjithë kishin detyrime të njejtë për prindër.

Me qenëse familja e Murat Osmanit hyn në konflikt me fisin Karmaj të Mirditës, vendosë ta largojë

Sylejman Turkun duke e çuar tek Bushatlijtë e Shkodrës, tek Shaban Efendia, gjyshi i Sylço Begut. Ky vendim u muar rreth viteve 1820. Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, Sylejman Turku shkon rrogëtar tek Shaban Efendia në Shkodër dhe punon aty për katër-pesë vjet. Siç e kujtonte Sylejman Turku, në atë kohë në Shkodër kishte, veç Bedistenit, edhe tre dyqane: një që shiste kripë,

një cikërrimtar dhe një dyfekçi (që rregulloheshin armë). Në atë kohë, përsëri sipas tij, Ura e Bunës nuk ekzistonte, pasi Drini derdhej në Lezhë dhe kishte aq pak ujë Buna sa që kalohej me kapërcime mbi gurë të vendosur për këtë qëllim.

Fisi Karmaj vazhdon ta ndjekë këmbakëmbës Lekë Bicin për ta vrarë, pasi ai kishte tradhëtuar fenë e tij duke u konvertuar nga Lekë në Sylejman. Kjo gjë i bie në sy edhe familjes së Shaban Efendisë, ndaj dhe fillon të marrë masa që të mos i ndodhin gjë Sylejman Turkut. Gjatë kësaj kohe ai vë në dijeni drejtuesit e dy besimeve në Shkodër, kryemyftinë dhe ipeshkvin. Këta të dy së bashku thërresin Sylejman Turkun për të marrë vendimin e tij se cilen fe dëshironte për të mbajtur. Sylejman Turku në prezencën e kryemyftisë dhe të ipeshkvit mohon besimin katolik dhe pranon me kënaqësi besimin islam Kryemyftia e pajisë Sylejmanin me një shkrim të shenjtë në formë hajmalie, duke e pranuar në besimin Islam.

Shaban Efendi Begu bie në kontakt me Haxhi Isen Spahinë si vojvodë i bajrakut të Boksit dhe i kërkon me e mbajtë pranë fisit të tij, mbasi ndiqej nga fisi Karmaj dhe mund të rrezikohej jeta e tij po të qëndronte aty. Haxhi Isen Spahija e merr Sylejman Turkun dhe e strehon në shtëpinë e tij, duke i lëshuar një tra shtëpie, siç quhej hapsira mes dy trerëve (aq sa me shtruar një dyshek gjëresë), dhe i jep për grua, një nga bijat e fisit të tij. Nga ky moment Sylejman Turku bëhet dhëndërr i fisit të Spahijave. Në vendin e quajtur "Shegat e Ibre," ai i jep një pjesë të mallit dhe aty ai jeton deri sa vdes në vitin 1928, në moshën 125 vjeçare.

Me bijën e Spahijave Sylejman Turku lind dy djem, Dyl dhe Zeqir Sylejmanin, të cilët nuk lënë trashëgimtarë, vdesin. Gjithashtu vdes edhe gruaja e tij.

Martesen e dytë Sylejman Turku e bën me hallen e Bajram Idriz Nehanaj, me të cilën i lindin përsëri dy djem, Dervish dhe Rexhep Sylejmani, të cilët nuk arrijnë të lënë trashëgimtarë, i vdesin. Gjithashtu i vdes edhe gruaja e dytë.

Martesen e tretë Sylejman Turku e bën me Sutë Bajram Gruden, hallen e Man Alush Grudës nga Dragoçi, me të cilën i lindin nëntë fëmijë, katër djemë dhe pesë vajza. Djemët quheshin: Musë, Adem, Reshit e Zeqir Sylejmani. Vajzat quheshin: Zylfë, Mine, Hava, Rrukë dhe Zylë Sylejmani, të cilat jetojnë të gjitha. Gjithashtu i jetojnë edhe katër djemët.....

Sot, nga Lekë Bici, i konvertuar në Sylejman Turku (Karma) numërohen rreth 500 pasardhës, të gjallë dhe të vdekur, të gjithë myslimanë. Sot ka mbi 25 familje të vendosur në lagjen Rrasek të fshatit Boks, që rrjedhin prej tij.

Me konvertimin e tij në mysliman, Sylejman Turku bëri qabën pa shkuar në Qabe, duke lënë si pasardhës rreth 500 myslimanë të devotshëm të besimit Islam.

Duke qenë një njeri i veçantë Sylejman Turku bëhet objekt i artit figurativ. Piktori i mirënjohur shkodranë, Kolë Idromeno, i bën një pikturë në vaj në moshën njëqind vjeçare, duke i vënë diçidurën "Plaku njëqind vjeçar i Postribës", të cilën do ta paraqesim në këtë artikull.

Sylejman Turku ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912, gjithashtu merr pjesë edhe në Luftën e Koplikut në vitin 1920. por me qenë se ky ishte i vetëm në shtëpi dhe nuk kishte njeri tjetër që të çonte në luftë, i japin leje të largohet nga fronti pasi Postriba kishte një rregull për të marrë pjesë në luftë: "Nga një trim për tim (tym, shtëpi)". Ai kthehet në shtëpi i urdhëruar për të rritur fëmijët.

Sylejman Turku do të mbetet në historinë e Postribës si një rast i rradhë, si një gur i çmuar dhe shëmbull frymëzimi për besimtarët myslimanë dhe për brezat që do të vijnë.

*Nga Riza Spahija*



**بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ**  
BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIME

Tregtojme  
**MISH HALLALL**

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**Produkte Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"  
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT  
TE DRURIT

# ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bami-rës Islam), ju afro-n prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zy-rash
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale-sh  
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobil-it: 0692523565

